

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" NË MITROVICË

FAKULTETI EKONOMIK



PUNIM DIPLOME

Albana Zenjullahi

Mitrovicë, 2023

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" NË MITROVICË
FAKULTETI EKONOMIK
DEPARTAMENTI: MENAXHMENT DHE INFORMATIKË



PUNIM DIPLOME

ANALIZA E FAKTORËVE QË NDIKOJNË NË RRITJEN E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

Mentori:
Prof.Ass.Dr. Filloreta Demiri Kunoviku

Kandidati:
Albana Zenjullahi

Mitrovicë, 2023

UNIVERSITY "ISA BOLETINI" IN MITROVICA
FACULTY OF ECONOMICS
DEPARTMENT OF MANAGEMENT AND INFORMATICS



BACHELOR THESIS

ANALYSIS OF FACTORS AFFECTING THE INCREASE OF FOREIGN DIRECT INVESTMENT IN KOSOVO

Mentor:
Prof.Ass.Dr. Filloreta Demiri Kunoviku

The candidate:
Albana Zenjullahi

Mitrovicë, 2023

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" NË MITROVICË
FAKULTETI EKONOMIK
DEPARTAMENTI: MENAXHMENT DHE INFORMATIKË



PUNIM DIPLOME

Lënda: Hyrje në biznes

Titulli i punimit: Analiza e faktorëve që ndikojnë në rritjen e investimeve të huaja direkte në Kosovë

Emri dhe mbiemri: Albana Zenjullahi

Statusi i studentit: I rregullt

Numri amzës (ID Regjistri): 1605021045

Niveli i studimeve: Bachelor

Departamenti: Menaxhment dhe informatikë

Mentorja e punimit: Prof.Ass.Dr. Filloreta Demiri Kunoviku

Aprovuar prej komisionit:

1.

/EmriMbiemri, Titulli/ _____, mentor

2.

/EmriMbiemri, Titulli/ _____, anëtar

3.

/EmriMbiemri, Titulli/ _____, anëtar

Data e aprovimit: _____

Deklarata e Origjinalitetit / Autorësisë

Ky Punim Diplome i nivelit bachelor është puna ime origjinale duke respektuar autorësinë e çdo burimi të informacioneve dhe rregullave për një punim të mirëfilltë shkencorë, dhe nuk është dorëzuar, në tërësi apo pjesërisht, për ndonjë gradë në këtë apo ndonjë universitet tjetër. Sipas njohurisë time, punimi nuk përmban asnjë material të botuar ose shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç siç deklarohet në brendi të tekstit. Gjithashtu, deklaroj se, në shkrimin e punimit kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të UIBM.

Statement of Originality / Authority

This Diploma Thesis, bachelor level, is my original work, respecting the authorship of any source of information and rules for a proper scientific work, and has not been submitted in whole or in part to any degree at this or any other university. According to my knowledge, the paper does not contain any material published or written by any other person except as stated in the text. Also, i declare that writing the thesis i have respected the ethical rules of the scientific and academic work of UIBM.

Data\Date:

Studenti-ja

(nënshkrimi-signature)

FALENDERIM

Në radhë të parë dua ta Falenderoj Zotin që më ka ndihmuar te arrij te diplomoj në fushën e ekonomisë, drejtim te cilin gjithmone e kam dëshiruar. Po ashtu dua të falënderoj ata që ishin me mua dhe pranë meje gjatë tërë kësaj periudhe kohore të studimeve , për të cilët dua të shpreh mirënjohjen time të thellë.

Falenderim i veçantë dhe meritë e veçantë për udhëheqësen e punimit, Prof. Ass.Dr. Filloreta Demiri Kunoviku e cila fillimisht ka pranuar të jetë mentore e imja po ashtu falenderoj për mbështetjen dhe ndihmën që më ka dhënë gjatë punimit.

Në fund të këtij punimi dua ta përshëndes dhe ta falënderoj nga zemra familjën time te ngushtë, prindërit e mi që pa ndihmën e tyre nuk do të arrija deri këtu ku jam sot.

ABSTRAKTI

Investimet e huaja direkte janë një faktor kryesor i integritit ekonomik ndërkombëtar dhe faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të një vendi dhe përjashtim nuk bën as Kosova. Rëndësi e veçantë i kushtohet dhe faktorëve të cilët ndikojnë në rritjen e investimeve të huaja direkte dhe në këtë aspekt Kosova ka disa përparsi sepse taksat janë shumë të ulëta, fuqi të re puntore, sistem të sigurt bankar, strukturë moderne ligjore dhe në pajtim me BE-në si dhe monedha zyrtare në Kosovë është euro, që eliminon rrezikun e eurozonave.

Duke e ditur rëndësinë që investimet e huaja direkte e kanë në zhvillimin ekonomik të një vendi, qëllim kryesor i këtij punimi është analiza e faktorëve të cilët ndikojnë në rritjen e investimeve të huaja direkte në Kosovë.

Duke u bazuar në rezultatet e punimit mund të konkludojmë se kemi rritje të investimeve të huaja direkte në vitin 2022 krahasuar me vitet paraprake. Duke u bazuar në literaturën e hulumtuar dhe konkludimet e dhëna ne mund të rekomandojmë se duhet të ketë investime më të mëdha në reklama, infrastrukturë dhe teknologji pasi Kosova përbën potencial të madh për investime të huaja direkte.

ABSTRACT

Foreign direct investments are a main factor of international economic integration and a very important factor for the economic development of a country, and Kosovo is no exception. Special importance is given to the factors that influence the growth of foreign direct investments and in this aspect, Kosovo has several advantages because taxes are very low, new workforce, safe banking system, modern legal structure and in accordance with the EU -and, the official currency in Kosovo is the euro, which eliminates the risk of the eurozone.

Being aware about the importance that foreign direct investments have in the economic development of a country, the main purpose of this paper is the analysis of the factors that influence the growth of foreign direct investments in Kosovo.

Based on the given results, we can conclude that we have an increase in foreign direct investments in 2022 compared to previous years. Based on the researched literature and the conclusions given, we can recommend that there should be greater investments in advertising, infrastructure and technology as Kosovo represents a great potential for foreign direct investments.

PËRMBAJTJA

Deklarata e Originalitetit / Autorësisë	iii
Statement of Originality / Authority	iii
FALENDERIM.....	iv
ABSTRAKTI	v
ABSTRACT.....	vi
PËRMBAJTJA.....	vii
LISTA E TABELAVE.....	ix
LISTA E FIGURAVE.....	x
I. HYRJE.....	1
1.1 Qëllimi i punimit	1
1.2 Objektivat e punimit.....	2
1.3 Metodologjia	2
II. RISHIKIMI I LITERATURËS	3
2.1 Definimi i investimeve të huaja direkte	3
2.1.1 Qëllimet e investimeve të huaja direkte	4
2.2 Teoritë e investimeve të huaja direkte.....	5
2.3 Klasifikimi i investimeve të huaja direkte.....	7
2.3.1 IHD horizontale	8
2.3.2 IHD vertikale	8
2.3.3 IHD konglomerate	8
2.4.4 Platforma IHD	9
2.4 Kushtet e duhura për tërheqjen e investimeve të huaja direkte.....	9
2.5 Avantazhet dhe disavantazhet e investimeve të huaja direkte.....	10
III. INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	13
3.1 Përparsitë e Kosovës për investime të huaja direkte	13
3.1.1 Mjedisi i biznesit në Kosovë	14

3.1.2 Regjimi i Tregut të Lirë	14
3.1.3 Stabiliteti Ekonomik	15
3.1.4 Kosto e ulët e operimit.....	15
3.1.5 Tatimet më të ulta në rajon	16
3.1.6 Vendndodhja qendrore gjeografike	17
3.1.7 Valuta stabile (Euro) dhe inflacioni i ulët	17
3.2 Mundësitë e investimit në Kosovë	18
3.2.1 Energjia dhe minierat.....	18
3.2.2 Bujqësia dhe blegtoaria	19
3.2.3 Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi – TIK	19
3.2.4 Turizmi	20
3.3 Statistikat e investimeve të huaja direkte në Kosovë	21
3.3.1 Investimet e huaja direkte në Kosovë sipas shteteve.....	22
3.3.2 Investimet e huaja direkte në Kosovë sipas aktivitetit ekonomik	23
3.3.3 Investimet e huaja direkte në Republikën e Kosovës në vitin 2022	24
IV. KONLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	27
V. BIBLIOGRAFIA	28

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Krahasimi i normave tatimore midis Kosovës dhe vendeve të rajonit.....	17
Tabela 2: Largësia në km nga Prishtina në Qendra Rajonale.....	18

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve në milionë euro.	22
Figura 2: Investimet e huaja direkte në Kosovë sipas shteteve.....	23
Figura 3: Investimet e huaja direkte në Kosovë sipas aktivitetit ekonomik.....	24
Figura 4: Investimet e huaja direkte në Kosovë bazuar në raportet 3 mujore për vitet 2019,2020,2021 dhe 2022.....	26

I. HYRJE

Në përgjithësi, investimet e huaja direkte bëhen në ekonomi të hapura që kanë një fuqi punëtore të kualifikuar dhe potencial për rritje. Investimet e huaja direkte ndodhin kur një investitor krijon operacione biznesi të huaja, duke përfshirë fillimin e pronësisë ose kontrollin e interesit në një kompani të huaj.

Investimet e huaja direkte (IHD) ndodhin kur një individ ose biznes zotëron të paktën 10% të një kompanie të huaj. Kur investitorët zotërojnë më pak se 10%, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) e përcakton atë thjesht si pjesë të një portofoli aksionesh. Ndërsa një pronësi prej 10% në një kompani nuk i jep një investitori individual një interes kontrollues në një kompani të huaj, ajo lejon ndikim mbi menaxhimin, operacionet dhe politikat e përgjithshme të kompanisë (CALIMANU, 2021).

Ekzistojnë lloje të ndryshme të IHD-ve të cilat variojnë në bazë të llojit të kompanive të përfshira dhe arsyeve të investimeve. Një investitor i IHD-ve mund të blejë një kompani në vendin e synuar me anë të një blerjeje, duke krijuar një sipërmarrje të re ose duke zgjeruar operacionet e një ekzistuese. Forma të tjera të IHD-ve përfshijnë blerjen e aksioneve në një ndërmarrje të lidhur, inkorporimin e një kompanie me pronësi të plotë dhe pjesëmarrjen në një sipërmarrje të përbashkët kapitali përtej kufijve ndërkombëtarë. (CALIMANU, 2021).

IHD mund të ndikojnë pozitivisht në një vend duke e zhvilluar ekonomikisht, duke e rritur tregtinë ndërkombëtare, në punësim, pagesë të taksave, këmbim të njohurive e shumë fusha tjera me rëndësi.

Roli dhe rëndësia e Investimeve të huaja direkte është i madh për një shtet kurse përjashtim nuk bën as Kosova prandaj edhe kam zgjedhur të bëjë hulumtim për analizën e faktorëve që ndikojnë në rritjen e investimeve të huaja direkte në Kosovë.

1.1 Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij punimi është analiza e faktorëve të cilët ndikojnë në rritjen e investimeve

të huaja direkte në Kosovë. Përmes këtij punimi arrijmë të kuptojmë se cilët janë faktorët që ndikojnë në rritjen e investimeve të huaja direkte në Kosovë, shuma e investimeve të huaja direkte në Kosovë, në cilët sektorë dhe dallimet mes viteve të fundit.

1.2 Objektivat e punimit

Objektivat e punimit janë:

- Të analizohen faktorët të cilët ndikojnë në rritjen e investimeve të huaja direkte në Kosovë.
- Të analizohen investimet huaja direkte në Kosovë viteve të fundit me fokus të veçantë në vitin 2022.
- Të identifikohen faktorët që ndikojnë në ngritjen e investimeve të huaja direkte në vendin tonë.

1.3 Metodologjia

Materiali që përmban ky punim bazohet kryesishtë në literaturë studimore si dhe kërkimore të ndryshme në internet. Si metodologji është përdorur kombinimi dhe strukturimi i lirë i materialit, mendimeve, ideve dhe kërkimeve duke u munduar të bëhet një renditje kronologjike e saktë e koncepteve në mënyrë që shpjegimi të jetë sa më i kuptueshëm dhe i saktë për të gjithë.

Punimi është i përbërë nga të dhënat sekondare të cilat janë siguruar nga raporte të ndryshme zyrtare të institucioneve të ndryshme në vendin tonë.

II. RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1 Definimi i investimeve të huaja direkte

Investimet e huaja direkte janë një ose disa aksione pronësore në një kompani të huaj, i bërë nga një investitor, kompani ose qeveri nga një vend tjetër.

Në përgjithësi, termi përdoret për të përshkruar një vendim të një biznesi të caktuar për të blerë një ose disa aksione në një biznes të huaj ose për ta blerë atë plotësisht me qëllimin kryesor për të zgjeruar operacionet në një rajon të ri. Termi zakonisht nuk përdoret për të përshkruar një investim aksionesh vetëm në një kompani të huaj. IHD-të janë një element kyç në integrimin ekonomik ndërkombëtar, sepse ato krijojnë lidhje të qëndrueshme dhe afatgjata midis ekonomive, jo vetëm të dy bizneseve por edhe të dy vendeve (HAYES, 2023)

Investitorët e IHD-ve zakonisht marrin pozicione kontrolluese në firmat vendase ose sipërmarrjet e përbashkëta dhe janë të përfshirë në mënyrë aktive në menaxhimin e tyre, ku ata kontrollojnë financat dhe marketingun. Investimet e huaja direkte përfshijnë blerjen e një ose disa burimeve të materialeve, zgjerimin e famës së një kompanie ose zhvillimin e një pranie shumëkombëshe të kompanisë (HAYES, 2023).

Investitorët e huaj direkt më të mëdhenj gjatë disa viteve të fundit kanë qenë kompanitë nga Shtetet e Bashkuara dhe ato nga Kina. Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) kanë qenë kontribuuesit kryesorë në IHD përtej kufijve të tyre.

Kompanitë ose qeveritë që vendosin të bëjnë një investim të huaj direkt në përgjithësi preferojnë firmat ose ekonomitë e hapura që ofrojnë një fuqi punëtore të kualifikuar dhe perspektiva mbi mesataren e rritjes për investitorin. Poashtu këto kompani preferojnë të investojnë në vende ku qeveria ka politika të lehta sa i përket IHD-ve. IHD-të shpesh shkojnë përtej investimeve të thjeshta kapitale, dhe mundë të përfshijnë gjithashtu ofrimin e menaxhimit, teknologjisë dhe pajisjeve për kompaninë në të cilën investojnë. Një tipar shumë i rëndësishëm i investimeve të huaja direkte është se kompanitë vendosin një kontroll

efektiv të biznesit të huaj ose të paktën një ndikim thelbësor mbi vendimmarrjen e tij (HAYES, 2023).

Qarkullimi vjetor sa i përket parave është shumë i madh me më shumë se 1.8 trilion dollarë investime të huaja direkte të bëra në vitin 2021. Shtetet e Bashkuara ishin destinacioni kryesor i IHD-ve në mbarë botën, pasuar nga Kina, Kanadaja, Brazili dhe India. Për sa i përket daljeve të IHD-ve, SHBA-ja ishte gjithashtu lider, e ndjekur nga Gjermania, Japonia, Kina dhe Anglia.

Investimet e huaja direkte janë poashtu një tregues i mirë i rritjes së buxhetit të vendeve me buxhet të lartëm kështu psh investimet e huaj direkte paraqesin 1.7% të buxhetit total të Kinës , krahasuar me 1% të SHBA-ve edhe pse sigurisht në terma nominalë ekonomia e SHBA është më e zhvilluar në krahasim me atë të Kinës. Për ekonomitë më të vogla dhe dinamike, IHD-të si përqindje e buxhetit total është dukshëm më i lartë sepse këto vende kanë buxhet më të vogël (HAYES, 2023).

IHD-të mund të bëhen në mënyra të ndryshme, duke përfshirë hapjen e një filiali ose shoqërie të asociuar në një vend të huaj, marrjen e një kontrolli në një kompani të huaj ekzistuese, ose me anë të një bashkimi ose sipërmarrjeje të përbashkët me një kompani të huaj.

Pragu për një IHD që vendos një interes kontrollues, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), është një minimum prej 10% të aksioneve të pronësisë në një kompani me bazë të huaj. Ky përkufizim është fleksibël. Ka raste kur interesi efektiv kontrollues në një firmë mund të krijohet duke blerë më pak se 10% të aksioneve me të drejtë vote të kompanisë (HAYES, 2023).

2.1.1 Qëllimet e investimeve të huaja direkte

IHD-të kanë rëndësi shumë të madhe në ekonominë e një vendi, dhe poashtu egzistojnë disa qëllime se pse ato bëhen dhe do të tregohen mëposhtë:

1. Mbajtja e një niveli të lartë investimi. Meqenëse vendet e pazhvilluara duan të industrializohen brenda një periudhe të shkurtër kohe, është e nevojshme të rritet

ndjeshëm niveli i investimeve. Kjo kërkon, nga ana tjetër, një nivel të lartë investimesh të huaja të cilat e mbulojnë këtë boshllëk (Kafle, 2016).

2. Hendeku teknologjik ku vendet e pazhvilluara kanë nivel shumë të ulët të teknologjisë në krahasim me vendet e përparuara. Megjithatë ata kanë një dëshirë të fortë për industrializimi për të zhvilluar ekonomitë e tyre dhe për të kaluar nivelin e ulët në të cilin janë kapur. Kjo ngre domosdoshmërinë e importimit të teknologjisë nga vendet e avancuara. Një teknologji e tillë zakonisht vjen me kapital të huaj kur merr formën e huaj private investimi apo bashkëpunimi i huaj (Kafle, 2016).
3. Shfrytëzimi i burimeve natyrore - Një numër vendesh të pazhvilluara zotërojnë burime të mëdha minerale, të cilat presin të shfrytëzohen. Vetë këto vende nuk zotërojnë aftësitë e nevojshme teknike dhe ekspertizë për të përmbushur këtë detyrë. Si pasojë, ata duhet të varen nga kapitali i huaj për të ndërmarrë shfrytëzimin të pasurisë së tyre të cilën ata e posedojnë (Kafle, 2016).
4. Ndërmarrja e rrezikut fillestar ku shumë vende më pak të zhvilluara vuajnë nga sipërmarrës private të cilët nuk rrezikojnë në ide të reja të investimit në biznese. Kjo krijon pengesa në programet e industrializimit. Argumenti i ngritur në favor të kapitalit të huaj është se ai merr përsipër rrezikun e investimet në vendet pritëse dhe në këtë mënyrë i jep shtysën shumë të nevojshme procesi i industrializimit.
5. Zhvillimi i infrastrukturës bazë ekonomike Është vënë re se kapitali vendas e vendeve në vendet e pazhvilluara shpesh është tepër e pamjaftueshme për të ndërtuar infrastrukturën ekonomike. Kështu këto vendetë kërkojnë ndihmën e kapitalit të huaj për të arritur këtë detyrë (Kafle, 2016).

2.2 Teoritë e investimeve të huaja direkte

Teoritë kryesore të IHD-ve shpjegohen më poshtë:

1. Kjo teori është bërë për herë të parë nga Venomi në vitin 1966, kryesisht për të treguar se si kompanitë Amerikane kanë investuar në Evropë pas luftës së dytë botërore. Venomi besoj se egzitojnë 4 faza (inovacioni, rritja, pjekuria, rënia) nepërmjet të cilave shpjegohet veprimtaria e IHD-ve. Faza e parë është faza ku

bizneset në Shtetet e Bashkuara të Amerikës krijojnë disa produkte të reja dhe ato që teprojnë i eksportojnë kryesisht në Evropë. Në vitet 70-ta kërkesat për produktet nga SHBA-të ka qenë mjaft e madhe prandaj edhe bizneset duke e shfrytëzuar avantazhin e teknologjisë kanë pasur fitime të mëdha, mirëpo edhe me kalimin e kohës edhe bizneset evropiane kanë filluar të kopjojnë produktet e bizneseve amerikane.(Denisia, 2010). Kështu, firmat evropiane kanë filluar të imitojnë produktet amerikane Kompanitë amerikane u detyruan të kryenin prodhim objektet në tregjet lokale për të ruajtur pjesën e tyre të tregut në ato zona. Kjo teori arriti të shpjegojë disa lloje të investimeve në Evropën Perëndimore të bëra nga Kompanitë amerikane midis viteve 1950-1970 (Denisia, 2010).

2. Teoria e këmbimit të kurseve në tregjet jostabile. Kjo është një tjetër teori që u përpoq të shpjegonte IHD-të. Fillimisht rreziku i këmbimit valutor ka është analizuar nga këndvështrimi i tregtisë ndërkombëtare Cushman analizoj ndikimin e pasigurisë si një faktor i IHD-ve. Analizën e vetme empirike e ka bërë Cushman i cili pretendoj se mbiqimi i valutës (dollar) ka dërguar në zvoglim të veprimtarisë së IHD-ve me 25%, edhe pse ka patur kundërshtime në lidhje me këtë teori. Mirëpo kjo teori nuk ka qenë e vërtetuar me monedha të llojeve tjera, prandaj mbetet vetëm teori.(Cushman, 1985).
3. Teoria e brendësisë kjo teori shpejton se si duhet të motivohen kompanitë që të rriten dhe të bëjnë sa më shumë IHD-ve. Teori u lansua për here të pare nga Coase në vitin 1937 në një dhe më pas u bë e famshme nga Hymer në 1976. Hymeri në temën e tij të doktoraturës identifikoj se dy ishin përcaktuesit kryesorë të veprimtarisë së investimeve të huaja direkte. Njëra ishte largimi i konkurrencës sidomos të bizneseve të llojeve të njehta dhe e dyta ishte shfrytëzimi i përparësive të cilat i kanë bizneset në krahasim me bizneset tjera në maksimum. Hymer është autori i konceptit të avantazheve specifike të firmës dhe demonstroi se IHD-të ndodhin vetëm nëse përfitimet e shfrytëzimit të avantazheve specifike të firmës tejkalojnë kostot relative të operacioneve jashtë vendit (S.Hymer, 1976). Hymer ka diskutuar problemin e kostove të informacionit për firmat e huaja të respektuara për

firmit vendase, trajtimin e ndryshëm të qeverive, rrezikun e monedhës. Rezultati nënkuptonte të njëjtin përfundim: kompanitë përballen me disa kosto rregullimi kur investimet kryhen jashtë vendit. Hymer pranoi se IHD-të janë një vendim strategjic në nivel firme dhe jo një vendim financiar i tregut të kapitalit (S.Hymer, 1976)

4. Paradigma eklektike e Dunning ku kjo teori ishte si përzierje e tri teorive të shpjeguara më lartë(Dunning, 1988).
 - a) Advantazhet e pronësisë ku kjo i referohet disa aktiveve jo-materiale, të cilat janë të paktën për një kohë, zotime ekskluzive të kompanisë dhe të cilat mund të sjellin për një kohë të caktuar fitime për kompaninë. Këto avantazhe janë kompetencat pronësore ose përfitimet specifike të kompanisë. (Dunning, 1988).
 - b) Lokacioni ku kur plotësohet kushti i parë, duhet të jetë më mirë për kompaninë qëi zotëron ato për t'i përdorur vetë, në vend që t'i shesë ose t'ua japë me qira firmave të huaja. Përparësitë e vendndodhjes së vendeve të ndryshme janë faktorë kyç për të përcaktuar se kush do të fitojë vende pritëse për aktivitetet e korporatave transnacionale(Dunning, 1988).
 - c) Brendësia- Duke supozuar se plotësohen dy kushtet e para, duhet të jetë fitimprurëse për kompaninë përdorimi i këtyre avantazheve, në bashkëpunim me (disa faktorë jashtë vendit të origjinës). Kjo karakteristikë e tretë e paradigmës eklektike ofron një kornizë për vlerësimin e mënyrave të ndryshme në të cilat kompania do të shfrytëzojë fuqitë e saj nga shitja e mallrave dhe shërbimeve deri te marrëveshjet e ndryshme që mund të nënshkruhen ndërmjet kompanive. Meqenëse përfitimet e brendshme të tregut ndërkufitar janë më të larta, aq më shumë firma do të dëshirojë të angazhohet në prodhim të huaj në vend që ta ofrojë këtë të drejtë me licencë, ekskluzivitet (Dunning, 1988).

2.3 Klasifikimi i investimeve të huaja direkte

Tregu i investimeve është një hapësirë e madhe. Investitorët individualë dhe kompanitë e mëdha mund të investojnë në kompani brenda vendeve të tyre, si dhe jashtë shtetit. Kur një

kompani investon në një biznes në një kompani tjetër në një tokë të huaj, investimi konsiderohet si investim i huaj direkt ose IHD. Ekzistojnë katër lloje të ndryshme të investimeve të huaja direkte (AngelOne, 2023) Ato janë treguar në pika të shkurta më poshtë:

2.3.1 IHD horizontale

Lloji më i zakonshëm i IHD-ve janë IHD-të horizontale, e cila ka të bëjë kryesisht me industrinë e llojit të njejtë, ku si shembull mund të marrim një kompani e cila investon në një kompani në një vend të huaj por që prodhojnë produkte gati të njejtja.

Për shembull, kompania e cila gjendet në Spanjë, Zara mund të investojë ose të blejë ose të investojë në një kompani të huaj të veshjeve, njejtë sikurse Zara. Meqenëse të dyja kompanitë i përkasin llojit të njejtë të industrisë, ky lloj i IHD-të klasifikohet si IHD horizontale (AngelOne, 2023).

2.3.2 IHD vertikale

IHD vertikale janë një tjetër lloj investimi i huaj direkt dhe ky investim kryhet brenda zingjirit të furnizimit dhe nuk ka lidhje nëse është industria prodhuese e llojit të njejtë ose jo. Për shembull, prodhuesi zviceran i kafesë Nescafe mund të investojë në plantacione kafeje në vende të tilla si Brazili, Kolumbia, Vietnami, etj. Meqenëse firma investuese blen, një furnizues në zinxhirin e furnizimit, ky lloj IHD njihet si integrim vertikal (AngelOne, 2023).

2.3.3 IHD konglomerate

Kur ndodhin investimet nga një kompani në një kompani të huaj e cila prodhon produkte të industrisë krejt të ndryshme, këto IHD njihen si IHD konglomerate Si e tillë, IHD-të nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me biznesin e investitorëve. Për shembull, shitësi me pakicë

amerikan Walmart mund të investojë në TATA Motors, prodhuesi indian i automobilave (AngelOne, 2023).

2.4.4 Platforma IHD

Platforma IHD është lloji i fundit i investimeve të huaja direkte dhe në këtë rast një kompani investon në një kompani të huaj e cila prodhon ose jo produkte të njejta, kurse produkti eksportohet ose shitet në një vend të tretë.

Për shembull, marka franceze e parfumeve Chanel ndërton një fabrikë të prodhimit të parfumeve në SHBA dhe pastaj produktin e eksporton në Evropë, Azi ose Afrikë (AngelOne, 2023).

2.4 Kushtet e duhura për tërheqjen e investimeve të huaja direkte

Disa nga kushtet ose strategjitë të cilat duhet ti zhvillojë një shtet për të rritur numrin e IHD-ve janë:

1. Duhet hapur tregjet dhe lejuar hyrjen e IHD-ve. Ulja e kufizimeve në IHD, sigurimi i kushteve të hapura, transparente dhe të besueshme për të gjitha llojet e bizneseve, të huaja apo vendase, duke përfshirë: lehtësinë e të bërit biznes, aksesin në importe, tregje relativisht fleksibël të punës dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (Morgan, 2017).
2. Krijimi i një Agjencie për Promovimin e Investimeve. Një agjenci e suksesshme mund të synojë investitorët e huaj të përshtatshëm dhe më pas mund të bëhet lidhja midis këtyre investitorëve dhe ekonomisë vendase. Roli i saj duhet të jetë i dyfishtë sepse nga njëra anë duhet të plotësojë kërkesat e investitorëve dhe nga ana tjetër duhet të tentoj të rrisë ekonominë e vendit pritës në maksimum. Për më tepër, ajo duhet të angazhohet në kujdesin pas investimit, duke pranuar këshillat nga investitorët e kënaqur dhe pranuar rekomandimet e tyre për riinvestime dhe duke ngritur grupe punuese për të rritur investimet e mëtejshme (Morgan, 2017).

3. Duhet analizuar detajisht sektorët në të cilët do të investohet duke u bazuar edhe nga politikat e vendit pritës, pozita gjeografike, kostoja e punëtorëve, transporti etj.
4. Duhet krijuar infrastrukturën e nevojshme si psh: transportin, furnizimin me energji, punëtorët e kualifikuar, lehtësira për trajnimin profesional të punëtorëve të specializuar, të projektuara në mënyrë ideale në bashkëpunimi me investitorin(Morgan, 2017).
5. Forcimi i lidhjeve të IHD-ve me ekonominë vendase. Duhet lejuar që të rritet konkurrenca sidomos me bizneset vendëse pasi kjo gjë rrit cilësinë e atyre produkteve (Morgan, 2017).
6. Duhet inkurajuar përhapjen e IHD-ve shumëkombëshe në ekonominë vendëse sepse menaxherët që punojnë në firmat shumëkombëshe kanë përvojë dhe janë të sukseshëm në krahasim me menaxherët lokalë. Menaxherët dhe punëtorët lokalë fitojnë njohuri për teknologjitë e reja dhe teknikat e marketingut duke studiuar dhe imituar konkurrentët e tyre shumëkombëshe(Morgan, 2017).
7. Roli i diasporës është shumë i rëndësishëm pasi diaspora e një vendi ka një lidhje emocionale me vendin pritës dhe shumë lehtë mund të krijohen lidhje me kompanitë vendore dhe bashkëpunimi do të ishte më i lehtë dhe i thjeshtë (Morgan, 2017).
8. Sigurimi i aksesit në kredi duke reformuar tregjet e brendshme financiare. Krijimi i një sistemi financiar miqësor për biznesin i ndihmon firmat indigjene t'u përgjigjen sfidave dhe impulseve nga hyrjet e huaja, të vetëpërzgjidhen në statusin e furnizuesit dhe në këtë mënyrë të rriten dhe të përparojnë(Morgan, 2017).

2.5 Avantazhet dhe disavantazhet e investimeve të huaja direkte

Përparësitë e IHD-ve janë:

1. Rritja e ekonomië: Një nga arsyt kryesore të rëndësishme që një vend (veçanërisht një vend në zhvillim) tërheq investime të huaja direkte është për shkak të krijimit të vendeve të punës. IHD-të rritin sektorin e prodhimit dhe të shërbimeve, i cili

krijon vende pune dhe ndihmon në uljen e shkallës së papunësisë në vendin e përmendur. Punësimi i rritur shpjegon të ardhura më të larta dhe i jep njerzëve më shumë mundëi blerje duke rritur ekonominë e përgjithshme (Prasanna, 2023).

2. Zgjerimi i kapitalit njerëzor: Kapitali njerëzor ka të bëjë me njohuritë dhe ekzistencën e fuqisë punëtore. Aftësitë e ndryshme të punëtorëve të fituara përmes trajnimeve dhe praktikave të ndryshme mund të avancojnë sistemin arsimor dhe kapitalin njerëzor të një vendi të caktuar (Prasanna, 2023)
3. Rritja e eksporteve ku shumë produkte të prodhuara nga IHD-të kanë tregje ndërkombtare dhe ato nuk bazohen vetëm në konsumin brenda shtetit. Prodhimi i produkteve të orientuara nga eksporti ndihmon për t'i shërbyer investitorëve të IHD-ve në mbështetjen e eksporteve nga vende të tjera të huaja (Prasanna, 2023).
4. Rrjedha e avancuar e kapitalit: Fluksi hyrës i kapitalit është veçanërisht i dobishëm për vendet me burime të kufizuara të brendshme dhe shanse të kufizuara për të rritur stoqet në tregun global të kapitalit (Prasanna, 2023).
5. Tregu konkurrues: Duke promovuar hyrjen e organizatave të huaja në tregjet e brendshme, IHD-të mbron krijimin e një mjedisi konkurrues brenda vetë prodhimitarëve vendor (Prasanna, 2023)

Disavantazhet e IHD-ve janë:

1. Pengesë në investimet e brendshme: Nganjëherë, IHD-të mund të ndërhyjnë në investimet e brendshme. Për shkak të IHD-ve, bizneset lokale të vendeve fillojnë të humbasin interesin për financimin e aseteve të familjeve të tyre (Prasanna, 2023).
2. Kostot më të shtrenjta: Kur investitorët investojnë në biznese në qarqe të huaja, ata mund të vërejnë rritjen e shpenzimeve në krahasim me mallrat e eksportuara vendase. Shpesh, më shumë para investohen në motorë dhe burime intelektuale, sesa në fitime për punëtorët vendas (Prasanna, 2023).
3. Mosarritshmëria financiare: Duke pranuar se IHD-të mund të jenë intensive për kapital nga pikëpamja e investitorëve, ato mund të jenë ndonjëherë shumë të rrezikshme ose ekonomikisht jo të besueshme (Prasanna, 2023)

4. Kolonializmi modern tregtar: Bota e tretë me një histori kolonializmi shpesh shqetësohet se IHD-të do të përfundonin në kolonializmin modern ekonomik, duke zbuluar vendet pritëse dhe duke i lënë ato të pambrojtura ndaj shtypjes nga kompanitë e huaja (Prasanna, 2023).

III. INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

3.1 Përparsitë e Kosovës për investime të huaja direkte

Institucionet e Kosovës vazhdimisht përpiqen t'i promovojnë anët positive dhe atraktive të investimeve në vend. Është kjo një shtytje për themelimin e Agjencisë Kosovare për Promovimin e Investimeve (AKPI) dhe ka për qëllim mbështetjen e IHD-ve në Republikën e Kosovës. AKPI ofron një spektër të gjerë të programeve mbështetëse për t'i ndihmuar bizneset ndërkombëtare t'i arrijnë qëllimet e tyre të zhvendosjes. Gjithashtu, Agjencia është e ngarkuar me promovimin e eksporteve (Roka, 2016). Sipas institucioneve shtetërore që promovojnë vlerat dhe të arriturat e Kosovës në bërjen e një ambienti atraktiv për investitorë të huaj, disa nga përfitimet të cilat cilësohen fitimprurëse për investitorë në Kosovë janë:

- Taksat në Republikën e Kosovës janë shumë të ulëta në krahasim me vendet fqinje.
- Sistemi tatimor është shumë i thjeshtë për tu përdorur.
- Fuqia punëtore është e re dhe e motivuar për punë dhe kanë njohuri të mirë të gjuhëve të huaja.
- Resurse të lakmueshme natyrore: linjit, zink, plumb, dhe elemente tjera.
- Qasje të lirë në tregun e Bashkimit Evropian dhe tregjet e shteteve fqinje.
- Institucione shtetërore i përkrahin shumë bizneset.
- Bizneset mund të regjistrohen shumë shpejtë dhe lehtë (brenda tri ditëve).
- Sistem të sigurt bankar
- Strukturë modern ligjore dhe në pajtim me Bashkimin Evropian dhe
- Monedha zyrtare në Republikën e Kosovës është euro, që eliminon rrezikun e eurozonave.

Pas pavarësisht Republika e Kosovës ka patur një zhvillim të madh në shumë fusha si në atë të stabilitetit politik, sigurisë, ekonomisë dhe legjislacionit etj. (Roka, 2016). Disa nga përparsitë më të rëndësishme do të tregohen edhe mëposhtë në pika më të zgjeruara.

Krahas përparësive Kosova ka edhe mangësi në aspektin e IHD-ve dhe ato janë:

- Tregu i vogël lokal
- Te ardhura të vogla për kokë banori
- Infrastrukturë jo të mirë
- Teknologji industriale të vjetruar
- Sektor shumë të dobët nga aspekti financiar
- Konkurrencë të madhe të vendeve afër saj (Roka, 2016).

3.1.1 Mjedisi i biznesit në Kosovë

Sa i përket mjedisit të biznesit në Republikën e Kosovës, lirisht mund të themi se është duke u bërë një ndër më konkurruesit në rajon dhe disa nga arsyt janë sistemi i favorshëm i taksave, regjistrimi i lehtë, ligjet e favorshme, fuqia e lire punëtore (Roka, 2016).

Për bizneset të cilat kërkojnë të investojnë në një vend me pozitë strategjike me fuqi punëtore të re dhe punëtore, Republika e Kosovës është zgjedhje ideale (Roka, 2016).

Raporti i Bankës Botërore për të bërit biznes 2020, i publikuar me 24 tetor 2019, konfirmon progresin gradual dhe të qëndrueshëm të Kosovës drejt krijimit të një klime të favorshme për biznes dhe tërheqje të investimeve në vendin tone (KIESA, 2023)

Megjithëse, në raportin për vitin 2020, Kosova ka shënuar një rënie në rangim në pozitën 57-të (nga pozita 44 sa ishte në vitin 2019), dallimi në rangim mes këtyre dy viteve nuk është plotësisht i krahasueshëm për shkak të ndryshimeve metodologjike dhe ndryshimit të të dhënave, që është bërë në mënyrë retroaktive nga Banka Botërore për disa vite.

Progresi i bërë nga Kosova është evident nga analizimi i të dhënave nga raporti që tregojnë se Kosova ka shënuar një përmirësim prej plus (+) 2.2 % në lehtësinë e të bërit biznes dhe ka pasur progres në 7 indikatorë nga 10 sa janë gjithsej (KIESA, 2023).

3.1.2 Regjimi i Tregut të Lirë

Sa i përket Regjimit të tregut të lire duhet përmendur Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit me Bashkimin Evropian:

- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me BE ku përfshihen 28 shtete
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Evropën Qendrore (CEFTA), përfshinë shtatë vendet jo-anëtare të Bashkimit Evropian (KIESA, 2023).

3.1.3 Stabiliteti Ekonomik

Zhvillimi i ekonomisë, i cili realisht matet me prodhimin e brendshëm bruto ka qenë në rritje të vazhdueshme pavarësisht disa krizave të vogla kombtare dhe ndërkombtare (KIESA, 2023).

Investimet të cilat po bëhen nga sektori privat janë duke ndikuar jashtëzakonisht shumë në rritjen e ekonomisë, dhe kjo gjë vërehet shumë sidomos në aspektin financiar. Qeveria e Republikës së Kosovës është duke zbatuar një politikë fiskale të qëndrueshme dhe largpamëse. (KIESA, 2023)

Republika e Kosovës poashtu është duke zbatuar një sistem të politikës monetare të qëndrueshme dhe është një prej vendeve të pakta që e ka paraqitur Euro-n si monedhë zyrtare të saj.

Për arsye se në Republikën e Kosovës nuk përdoret asnjë monedhë tjetër përveq Euros, Kosova nuk ka asnjë rrezik monetar dhe pritet të ketë politika të qëndrueshme monetare (KIESA, 2023).

3.1.4 Kosto e ulët e operimit

Avantazhi fuqisë punëtore në Republikën e Kosovës është kostoja e ulët e pagave të ture e cila sillet rreth 300–400-euro neto.

Disa nga avantazhet janë:

- Pakoja e re fiskale e cila përdoret për të rritur ekonominë: 8% për produktet bazë dhe 18% për produktet tjera
- Tatimi në Dividendë i cili është 0%.
- Liberalizimi i Importit

- Teknologjia Informative e re, dhe e përshtatshme.
- Sistemi i Prokurimit i cili është elektronik dhe mjaft i avancuar.(KIESA, 2023).

3.1.5 Tatimet më të ulta në rajon

Tatimet e larta pengojnë krijimin e vendeve tëpunës dhe nxitjen për të investuar në një vend.Në këtë aspekt Kosova krahasuar me vendet e rajonit ka ngarkesë të ulët tatimore(tëgjithatëtatimet Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH); Tatiminë të ardhura personale (TAP) dhe Tatimi në të ardhura te korporatave(TAK), ku normat tatimore janë më të ulëtat në rajon).

IETL përmes këtij studimi jep informacion të vlefshëm duke krahasuar ngarkesat tatimore në Kosovë me vendet e rajonit, përkatësisht në: Maqedoninë e Veriut, Serbinë, Bosnjën dhe Hercegovinën , Shqipërinë dhe Maline Zi,e cila mund të ju shërbej qeverisë në nivelin lokal dhe qendror për të promovuar tërheqjen e investimeve.

Aktualisht, në Kosovë janë tri norma për TVSH:(0%)për eksportet,(8%) për produktet esencial edhe (8%) për produktet e luksit. Duke e krahasu-ar me vendet e tjera të rajonit Kosova renditet si një nga vendet me normën më të ulët të TVSH-së në rajon

Sa i përket normës tatimore për të ardhurat e korporatave(TAK), Kosova e ka(10%) dhe renditet pas Malit të Zi me (9%), ndërsa Serbia(15%), Shqipëria (15%) dhe Kroacia (18%) kanënormat më të larta të këtij tatimit në rajon.

Përkitazi me normën tatimore për të ardhurat personale, Kosova aplikon normën më të favorshme krahasuar me vendete tjera të rajonit. Kosova aplikon norma progresive tatimore mujore të cilat fillojnë si në vijim: normata timore prej(0%) vlen për paga

Tabela 1: Krahasimi i normave tatimore midis Kosovës dhe vendeve të rajonit.

Shteti	Tatimi		
	TVSH	Tatimi në të Ardhurat e Korporatave	Tatimi në të Ardhurat Personale
Kosova	Norma standarde e TVSH-së është 18%	10%	0%- 4% 8% 10%
	Norma më e ulët e TVSH-së është 8%		
Maqedonia e Veriut	Norma standarde e TVSH-së është 18%	10%	10%
	Norma më e ulët e TVSH-së është 5%		
Serbia	Norma standarde e TVSH-së është 20%	15%	10%
	Norma më e ulët e TVSH-së është 10%		
Bosnja dhe Hercegovina	Norma standarde e TVSH-së është 17%	10%	10%
	Nuk ka normë të reduktuar të TVSH-së		
Kroacia	Norma standarde e TVSH-së është 25%	18%	36% ¹⁶
	Norma më e ulët e TVSH-së është 13% ¹⁷		

Oderi 80 euro/muaj; norma tatimore prej (4%) vlen për paga 80 deri 250 euro/muaj; norma tatimore prej (8%) vlen për paga 250 deri 450 euro/muaj; dhe norma tatimore prej (10%) vlen për pagambë 450 euro/muaj. Të dhënat e mësipërme janë ilustruar edhe në mënyrë grafike në tabelën 1.

3.1.6 Vendndodhja qendrore gjeografike

E vendosur në zemër të Ballkanit, Kosova shërbensiu rëndësishëm i lidhës midis vendeve të Evropës Juglindore, përmes transportit ajror, rrugor, hek-urudhor dhe tre porteve detare, si në tabelën 2.

3.1.7 Valuta stabile (Euro) dhe inflacioni i ulët

EURO u bë monedhë zyrtare që përdoret në Kosovë më 1 janar 2002, duke eliminuar në këtë mënyrë riskun e monedhës dhe kursit të këmbi- mit. Në veçanti, euro i dha

Tabela 2: Largësia në km nga Prishtina në Qendra Rajonale.

Qyteti	Kilometra	Qyteti	Kilometra
Shkup	86	Durrës	262
Selanik	329	Sarajevë	390
Tiranë	256	Bari	531
Beograd	355	Zagreb	741
Sofje	279	Budapest	747

Kosovës një përparësi të konsiderueshme ndaj konkurrentëve të saj në rajon duke e bërë atë më tërheqëse për investimet e huaja dhe duke sjellë stabilitet financiar dhe makroekonomik që mungon në shumë vendeve të rajonit. Për më tepër, kjo i mundësoi Kosovës të ofrojë kostot më të ulëta të transaksioneve në rajon.

3.2 Mundësitë e investimit në Kosovë

Kosova ka një numër të sektorëve që ofrojnë mundësi të mira të biznesit për të cilat do të flitet mëposhtë.

3.2.1 Energjia dhe minierat

Kosova disponon me resurse të shumta natyrore, vlerësohet të ketë rreth 12.5 miliardë tonelata me rezervave të linjtit duke zënë vendin e pestë në botë me rezervat e kësaj xeheje. Rezervat e linjtit përdoren si burim kryesor i prodhimit të energjisë në Kosovë dhe vlerësohet të zgjasin për 650 vitet e ardhshme, me ritmin e nxjerrjes aktuale. Rezervat e linjtit janë gjithashtu të shpërndara në basenin e Dukagjinit dhe Drenicës, por nxjerrja e xehes aktualisht është e kufizuar vetëm në basenin e Kosovës. Përveç linjtit, Kosova është gjithashtu e pasur me minerale të tjera si: alumini, ari, plumbi, zinku, bakri, boksiti, magnezi, azbesti, kromi, guri gëlqeror, mermeri dhe kuarci, zinku, çeliku, ari, kadmiumi, dhe bizmuti. Siç vlerësohet nga Banka Botërore, Kosova ka rezervat

e mëdha të resurseve natyrore të cilat ende mbeten të pash- frytëzuara, ndërsa janë potencial i madh për rritje në të ardhmen (Besa Zogaj Gashi, Serton Ajeti, Gent Beqiri, 2019).

Minierat Trepça: rreth 23,000 të punësuar, një kohë ishte ndër kompanitë më të mëdha në ish-Jugosllavi. Qeveria e Kosovës do të duhej të hartohet një strategji nacionale e zhvillimit ekonomik e cila do të ishte udhërrëfyes për reformat që duhet bërë në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik dhe një strategji të re për Trepçën. Për më shumë, ju lutemi vizitoni uebsa- jtin e Ministrisë së Kosovës për Zhvillim Ekonomik (Besa Zogaj Gashi, Serton Ajeti, Gent Beqiri, 2019).

3.2.2 Bujqësia dhe blegtoria

Republika e Kosovës është e pasur me tokë bujqësore; 53 për qind e sipërfaqes totale është tokë e punueshme. Aktualisht, sektori bujqësor kon- tribuon me vetëm 19 për qind të gjithsej njësisë vjetore të punës dhe 15 për qind të vlerës së eksportit. Përpunimi i ushqimit në Kosovë është menaxhuar tradicionalisht nga ndërmarrjet sho- qërore, ndërsa sot ato janë joaktive; ndërmarrjet e reja private kanë filluar të operojnë në këtë fushë. Shumica e këtyre kompanive janë të vogla dhe nuk kanë mundë të plotësojnë kërkesat e konsumit vendor prandaj një investim i duhur do të ishte ideal për tregjet vendore (Besa Zogaj Gashi, Serton Ajeti, Gent Beqiri, 2019).

2.2.3 Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi – TIK

Qeveria e Kosovës ka njohur rëndësinë strateg- jike të industrisë së TIK-ut për zhvillimin ekono- mik dhe transformimin strukturor drejt një ekonomie të bazuar në dije. Si rezultat, në 2013 Qeveria e Kosovës zyrtarisht e shpalli industrinë e TIK-ut sektor me përparësi të lartë për ekonominë e saj. Sipas një Ankete të Teknolog- jisë së Informacionit dhe Komunikimit të botuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), sektori i TIK-ut në vend po rritet me shpejtësi, duke qenë një nga përparësitë e qeverisë për pesë vitet e fundit (Besa Zogaj Gashi, Serton Ajeti, Gent Beqiri, 2019).

Kosova ka popullatën më të re në Evropë. Kjo popullatë është e aftë edhe flet shumë gjuhë të huaja, ku gjuha angleze është gati si një gjuhë zyrtare. Sipas publikimit të Eurostat-it “Shifrat bazë për vendet në zgjerim” – Botimi 2019, në vitin 2018, Kosova ka përqindjen e familjeve që kanë qasje në internet në shtëpi më të lartën në Rajon (93%).²⁶

Kosova ka dalë si një nga vendet kryesore të Evropës si burim për ofrimin global të shërbimeve të TI-së. Sipas Global Sourcing Association (GSA), Evropa Juglindore - rajoni i Kosovës është bërë një vend tërheqës për gjetjen e burimeve (Besa Zogaj Gashi, Serton Ajeti, Gent Beqiri, 2019).

/sektori i nënkontraktimeve të biznesit “out- source”; për shkak të kostos së ulët të stafit të kualifikuar dhe numrit të madh të profesionistëve të arsimuar, dygjuhësh dhe të kualifikuar të TI-së. Pothuajse 1/3 e kompanive të Kosovës janë të angazhuara në eksport të shërbimeve Shoqata International Association for Outsourcing Professionals ka zgjedhur Kosbit në mesin e TOP 100 Global Outsourcing Providers. Kosbit po punon me kompani të tilla si AT&T, IBM dhe Cisco, dhe me përvojë mbi një dekadë ofron gamë të gjerë shërbimesh, eksternalizim të shërbimeve TI, zgjidhje globale të telekomit, integrim të sistemeve dhe shërbime të zhvillimit të softuerit për të ulur kostot e TIK-ut, përmirësuar ofrimin e shërbimeve dhe për të mundësuar rritjen e biznesit. Stellarion (<https://stellarion.fi/>) është kompani e themeluar në Finlandë nga partnerë finlandezë dhe kosovarë. Ajo është zgjeruar shpejt dhe punon me projekte AR/VR përfshirë projektin në zhvillimin e turizmit për qytetin e Hämeenlinna. Kompania amerikane Kode Labs, kompani e specializuar në IT për ‘pasuri të paluajtshme komerciale’, bleu kompaninë kosovare Zag Apps, kompani e TI-së që zhvillon produkte softuerike. Këto janë vetëm disa shembuj për të treguar se sa i madh është potenciali i këtij sektori në Kosovë. Për më shumë, ju lutemi vizitoni uebsajtin e Ministrisë së Kosovës për Zhvillim Ekonomik (Besa Zogaj Gashi, Serton Ajeti, Gent Beqiri, 2019).

2.2.4 Turizmi

Pasuritë natyrore të Kosovës paraqesin burim të kualitetit të lartë për turizëm. Jugu malor i Kosovës ka potencial të madh për turizmin dimëror. Një nga mundësitë më interesante për investorët e huaj në këtë rajon është Qendra e Skijimit në Brezovicë, në malet e

Sharrit. Kjo qendër gjendet mes 1,700 dhe 2,500 m lartësi mbidetare. Ai ofron kushte të shkëlqyeshme të motit dhe borës si dhe sezon të skijimit nga nën- tori deri në maj.

Brezovica mund të arrihet për një orë me makinë nga dy aeroporte ndërkombëtare, Aeroporti i Prishtinës (60 km) dhe i Shkupit (70 km), dhe gjendet në Parkun Kombëtar të Sharrit në Republikën e Kosovës, vargmalet e Brezovicës shtrihen në 39,000 hektarë me terren të lartë malor alpin dhe pyje (Besa Zogaj Gashi, Serton Ajeti, Gent Beqiri, 2019).

Po ashtu, në Malet e Sharrit, në pjesën më jugore në kufi me Maqedoninë dhe Shqipërinë, Kosova ofron për privatizim rreth 22,000 hektarë të tokës së pashkelur në pjesët malore që i përka- sin NSH “Sharrprodhimi”.

Ky rajon ofron mundësi të shkëlqyeshme për turizëm si: skijimi, eko-turizmi, lëshimet me parashutë nga lartësitë malore, çiklizmi malor, ngjitja në shkëmbinj, ecja alpine, lundrimi me kajak, kalërimi, etj. Toka në Komunën e Dragashit ka bukuri magjepsëse. Ajo paraqet mundësi të jashtëzakonshme për eko-turizëm. Mundësi tjetër për investime është Qendra e Skijimit në Bjeshkët e Rugovës. Kosova është kryesisht e pasur me male, liqene artificiale dhe lumenj, gjë e cila ofron mundësi të mira për gjueti dhe peshkim.

Zeja e përhapur e punimeve artizanale në Kosovë, siç është Filigrani (me argjend), paraqet atraksion për turistët e huaj (Besa Zogaj Gashi, Serton Ajeti, Gent Beqiri, 2019).

Përveç kësaj, Kosova ka potencial për zhvillimin e turizmit kulturor me objekte të ndryshme religjioze me vlerë të jashtëzakonshme kulturore dhe historike.

Janë të njohura burimet e famshme termale të Kosovës, për shkak të efekteve shëruese të tyre. Për këtë lëmi, investitorët e huaj do të gjejnë kërkesë të madhe në tregun rajonal dhe atë të brendshëm (Besa Zogaj Gashi, Serton Ajeti, Gent Beqiri, 2019).

3.3 Statistikat e investimeve të huaja direkte në Kosovë

Sa i përket statistikave të IHD-ve në Republikën e Kosovës ne mund ti gjejmë në webfaqen e BQK-së ku edhe është bërë klasifikimi sipas sektorëve, shteteve dhe kriterëve gjeografike.

Raportet vjetore ekzistojne qe nga viti 2004 deri ne vitin 2022 qe na mundesojnë qasje te drejtperdrejt dhe lehtesim ne marrjen e informative, publikimi për për çdo tre muaj është shumë më e lehtë për të kuptuar se çfarë ka ndodhur gjatë viteve nëpër periudhat e caktuara. Sipas raportit te vitit 2021 IHD arritën vlerën prej 415.3 milionë euro, që paraqet një rritje prej 20.1% (rritje prej 35.8% në vitin 2020 dhe rënie prej 6.4% në vitin 2019) gjë të cilën mund ta shohim në figurën 1. Sa i përket llojit të IHD-ve investimet në kapital u rriten për 19.6% dhe investimet në instrumente të borxhit me 27.4%. Rritje e IHD-ve u evidentua kryesisht në sektorin e patundshmërive me rritje prej 91.3%.

3.3.1 Investimet e huaja direkte në Kosovë sipas shteteve

Stoku i investimeve të huaja nga viti 2007 deri në qershor të vitit 2021 është 4.4 miliard euro edhe në keto investime prin Gjermania me 810 milion euro apo me 18.4% e cila pasohet nga Zvicra me 673 milion euro apo me 15.3 %, Britania e madhe me 418 milion




Figura 1: Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve në milionë euro.

euro apo 9.5 %, Turqia me 381 milion apo me 8,6 % te investimeve direkte, dhe Austria me 356 milion apo 7,4 %. Këto pese shtete perbejne 60% te investimeve te huaja direkte në Kosovë gjë të cilën mund ta shohim në figurën 2 (BQK, Raporti vjetor 2021, 2022)

3.3.2 Investimet e huaja direkte në Kosovë sipas aktivitetit ekonomik

Stoku i IHD-ve nga viti 2007 deri në vitin 2021 është 4.4 miliard euro dhe në këto investime, aktivitete të patundshmërive përbëjnë 1.83 miliard euro apo 41.6% te totalit të investimeve të huaja, pasuar nga aktivitetet financiare dhe të sigurimit përbëjnë 732.2 milion euro apo 16.7%, prodhimi 380.5 milion euro apo 8.7%, dhe ndërtimtari 372.2 milion euro apo 8.5% të total investimeve gjë të cilën mund ta shohim në figurën 3.




Figura 2: Investimet e huaja direkte në Kosovë sipas shteteve.

Investimet e huaja Direkte në Kosovë 2007 - Qershor 2021 - sipas aktivitetit ekonomik




Figura 3: Investimet e huaja direkte në Kosovë sipas aktivitetit ekonomik.

3.3.3 Investimet e huaja direkte në Republikën e Kosovës në vitin 2022

Investimet e huaja direkte në tre mujorin e katërt për vitin 2022 kanë shënuar rritje prej 137.8 milionë euro dhe kanë arritur vlerën prej 163.9 milionë euro. Kjo rritje ka qenë kryesisht në sektorin e patundshmërisë.

Rritja e IHD-ve në këtë sektor u ndikua nga rritja e kostos së sektorit të ndërtimit (16.7% rritje në tre mujorin e katërt për vitin 2022). IHD e rezidentëve nga Kosova në vendet tjera poashtu ka shënuar rritje edhe kjo kryesisht në sektorin e patundshmërisë (BQK, Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 41, TM4 2022,, 2022).

IHD-të në tremujorin e tretë për vitin 2022 ka arritur vlerën prej 239.5 milionë euro, apo 41.2% më shumë krahasuar me vitin e kaluar. Rritja më e madhe është vërejtur tek 3 faktorë dhe ata janë: kapitali dhe fondi i investimeve në aksione dhe borgji. Struktura e IHD-ve vazhdon të jetë e koncentruar kryesisht në sektorin e patundshmërive (67.9 përqind e gjithsej IHD-ve në tremujorin e tretë për vitin 2022), të cilat shënuan rritje prej 32.9%. Edhe sektorët tjerë shënuan performancë të mire ku edhe investimet direkte të rezidentëve kosovarë në vende tjera ishin më të larta në TM3 2022 krahasuar me periudhën

e njëjtë të vitit paraprak dhe arritën vlerën prej 39.4 milionë euro (37.0 milionë euro në TM3 2021(BQK, Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 40, TM3 2022, , 2022).

Investimet e huaja direkte për tremujorin e dytë për vitin 2022 arritën në vlerë prej 210.78 milionë euro, apo 74.16% më shumë krahasuar me vitin paraprak. Rritja më e madhe është vërejtur tek fondit i investimeve dhe tek borgji. Struktura e IHD-ve dominohej nga patundshmëria dhe sektori financiar. Performanca e kompanive në sektorët tjerë ishte e mirë ku bilanci i fitimit të ri-investuar deri në qeshor ishte për 89.0 përqind më i lartë krahasuar me tremujorin e dytë për vitin 2021 (BQK, Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 39, TM2 2022,, 2022)

Investimet e Huaja Direkte (IHD) në TM1 2022 kanë arritur vlerën prej 147.4 milionë euro apo 42.1 përqind më shumë krahasuar me TM1 2021. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondit i investimeve në aksione ishte 128.2 milionë euro apo 38.2 përqind më shumë, ndërsa instrumentet e borxhit ishin 19.3 milionë euro apo 75.1 përqind më shumë krahasuar me TM1 2021 Rritje e IHD-ve u evidentua kryesisht në sektorin e patundshmërive (75.8% rritje), ku pjesëmarrja e këtij sektori në gjithsej IHD-të arriti në 95.8% nga 61.2% sa ishte në TM1 2021. Një rritje kaq e lartë e investimeve në patundshmëri mund t'i atribuohet edhe rritjes së inflacionit dhe zhvlerësimit të valutës euro, ku investitorë të ndryshëm janë ndjerë më të sigurt nga investimi në patundshmëri. Rritja e investimeve në patundshmëri vërehet edhe nga rritja e kredive hipotekare prej 53.2% në TM1 2022. Përveç investimeve në patundshmëri, IHD-të kanë shënuar rritje edhe në sektorin e xehetarisë, prodhimit, etj., ndërsa në sektorin e aktiviteteve financiare dhe të sigurimit, furnizimit me energji, etj. është shënuar rënie e IHD-ve. Investimet e huaja direkte grafikisht mund ti shohim në figurën 4 (BQK, Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 38, TM1 2022,, 2022)




Figura 4: Investimet e huaja direkte në Kosovë bazuar në raportet 3 mujore për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

IV. KONLUZIONE DHE REKOMANDIME

Duke u bazuar në hulumtimin e bërë mund të konludojmë si në vijim:

- Investimet e huaja direkte luajnë rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi dhe përjashtim nuk bën as Kosova.
- Kosova ka përparsi të madhe për tërheqjen e investimeve të huaja sepse taksat në Republikën e Kosovës janë shumë të ulëta krahasuar me vendet fqinje, sistemi tatimor është mbajtur jashtëzakonisht i thjeshtë, fuqi të re dhe të motivuar punëtore, gjithashtu njohuri të përgjithshme të shumicës së gjuhëve evropiane, procedurë të thjeshtë dhe të shpejtë për regjistrimin e bizneseve (brenda tri ditëve), sistem të sigurt bankar, strukturë moderne ligjore dhe në pajtim me BE-në dhe, monedha zyrtare në Kosovë është euro, që eliminon rrezikun e eurozonave.
- Ka rritje të investimeve të huaja direkte në vitin 2022, krahasuar me vitet paraprake me vlera të konsiderueshme.
- Aktivitetet e patundshmërive, aktivitetet financiare dhe të sigurimit, prodhimi dhe ndërtimtaria janë sektorët në të cilët investohet më së shumti.

Duke u bazuar në konkludimet e mësipërme rekomandoj:

- Investime më të mëdha në reklama, sidomos në reklamimin e turizmit pasi Kosova ka vende ku potencialisht mund të investohet.
- Investime në infrastrukturë, pasi kemi infrastrukturë të dobët
- Investime në teknologji industriale, pasi kemi teknologji industriale të vjetruar.

V. BIBLIOGRAFIA

- AngelOne. (2023). Types of FDI. *AngelOne*.
- Besa Zogaj Gashi, Serton Ajeti, Gent Beqiri. (2019). *INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË Klima e investimeve, potenciali dhe barrierat*. Prishtine, Republika e Kosoves: Instituti per Ekonomi te Tregut te Lire (IETL).
- BQK. (2022). *Raporti vjetor 2021*. Prishtine: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
- BQK. (2022). *Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 38, TM1 2022*,. Prishtine: Banka Qendrore e Republikës se Kosoves.
- BQK. (2022). *Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 39, TM2 2022*,. Prishtine: Banka Qendrore e Republikës se Kosoves.
- BQK. (2022). *Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 40, TM3 2022*, . Prishtine: Banka Qendrore e Republikës se Kosoves.
- BQK. (2022). *Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 41, TM4 2022*,. Prishtine: Banka Qendrore e Republikës se Kosoves.
- Cushman, D. O. (1985). *Real Exchange Rate Risk, Expectations, and the Level of Direct Investment*. The MIT Press.
- Denisia, V. (2010). *Foreign Direct Investment Theories: An Overview of the Main FDI Theories*. Bucharest: Academy of Economic Studies, Bucharest.
- Dunning, J. (1988). The Eclectic Paradigm of International Production: A restatement and some possible extensions. *Journal of International Business Studies*.
- Haxhimurati, H. (2018). *RËNDËSIA DHE ROLI I INVESTIMEVE TË HUAJA NË ZHVILLIMIN*. Prishtine: UBT.
- HAYES, A. (2023, March 27). Direct Foreign Investment (FDI): What It Is, Types, and Examples. *Investopedia*.
- Kafle, S. (2016). *Objectives of Foreign Direct Investment* . SlideShare.

- Kajoshaj, B. (2019). *Rëndësia dhe roli i investimeve të huaja në zhvillimin ekonomik të vendit tonë*. Prishtine: Universiteti i Prishtines.
- KIESA. (2023, 5 21). *Ministria e Tregtise dhe Industrise*. Retrieved 5 21, 2023, from kiesa.rks-gov.net: <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15>
- Kosovës, B. Q. (2022). *Raporti Vjetor 2021*. Prishtine: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
- LIMA, D. (2016). *INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË Analizë e atraktivitetit të investimeve të huaja dhe roli I tyre në Ekonomi*. Tirane: Universiteti Eueopian i Tiranës.
- Morgan, T. (2017). Attracting quality foreign direct investment in developing countries. *IGC*.
- Nagaraj, R. (2003). Foreign Direct Investment in India in the 1990s: Trends and Issues. *JTSOR*, 1701-1712.
- Prasanna. (2023). What is Foreign Direct Investment (FDI)? FDI Advantages and Disadvantages. *Aplus Topper*.
- Roka, S. (2016). *KAPITALI I BANKAVE AFARISTE*. Prishtine: UBT.
- S.Hymer. (1976). A Study of Foreign Direct Investment. *The International Operations of Nation Firms*.
- Selmani, M. (2021). *Ndikimi i investimeve të huaja direkte në efiçencën e çmimeve të paluajtshëmërive në Kosovë-zhvillimi ekonomik*. Prishtine: Kolegji ESLG.